

**Projekti 'Të drejtat sociale për grupet vulnerabël /të marginalizuara-SoRi'**

*Komuna e Prishtinës – Grupi punues për implementimin e projektit 'Të drejtat sociale për grupet vulnerabël /të marginalizuara-SoRi'*

**Thirrje për aplikim me projekte të OJQ-ve në financim të aktiviteteve ndërlidhur me promovimin dhe avancimin e të drejtave sociale**

Projekti përkrahët nga organizata Gjermane GIZ dhe financohet nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

**Prishtinë, Prill 2016**

## 1. HISTORIKU

Aderimi në BE është qëllimi i deklaruar politik nga pesë vendet e Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Kosovë dhe Serbi. Për më tepër, ata (me përjashtim të Kosovës) e kanë ratifikuar Kartën Sociale Europiane dhe kanë marrë përsipër detyrimin për të garantuar të drejtat gjithëpërfshirëse sociale. Megjithatë, ka ende mangësi në transpozimin e *acquis communautaire* pikërisht në fushat e politikës sociale dhe garantimin e të drejtave themelore të njeriut, përfshirë të drejtën për mosdiskriminim. Ata që vuajnë pasojat janë kryesisht anëtarë të grupeve vulnerabël, p.sh. minoritetet etnike (mbi të gjithë romët), refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit, personat me aftësi të kufizuara dhe gratë dhe vajzat.

Anëtarët e grupeve të pafavorizuara shpesh nuk kanë qasje të mjaftueshme në shërbimet sociale, arsim, shëndetësi dhe strehim. Kushtet e jetesës janë shpesh katastrofike. Shumë anëtarë të popullatës rome në Ballkanin Perëndimor jetojnë nën pragun e varfërisë kombëtare, dhe nuk janë në gjendje për të siguruar jetesën për veten e tyre. Ata varen nga ndihma e familjeve të tyre, ose nga shteti. Megjithatë, institucionet kompetente deri më tani nuk kanë qenë në gjendje për të mbështetur këta njerëz në mënyrë të mjaftueshme. Aktorët kryesorë lokal dhe kombëtarë nuk janë në gjendje të krijojnë kushtet e përshtatshme për të garantuar qasje të barabartë në të drejtat sociale për të gjitha grupet e cënueshme.

## OBJEKTIVI

***Aktorët kryesorë kanë përmirësuar kushtet për garantimin e të drejtave të barabarta themelore sociale për grupet në nevojë në komunat e përzgjedhura.***

Qëllimi është, nga njëra anë, për të siguruar që aktorët shtetërorë janë në gjendje të garantojnë të drejta gjithëpërfshirëse sociale të grupeve vulnerabël; dhe nga ana tjetër, që anëtarët e grupeve vulnerabël të kërkojnë që të drejtat e tyre janë plotësuar dhe të shohin veten e tyre si anëtarë të barabartë të shoqërisë. Kjo mund të çojë në forcimin e përfshirjes sociale, duke reduktuar diskriminimin dhe trajtimin e varfërisë dhe disavantazhet në afat të gjatë.

## PËRMBLEDHJE

Qëllimi i projektit është të përmirësojë kushtet për sigurimin e të drejtave të barabarta sociale të grupeve vulnerabël në komunat e përzgjedhura. Kryesisht institucionet shtetërore, të cilat janë subjektet përgjegjëse për të garantuar të drejtat e njeriut dhe shërbimet sociale, janë në fokusin e qasjes për të drejtave të njeriut. Përmes këtij projekti synohet ngritja e kapaciteteve (kapacitetet individuale të punonjësve dhe kapacitetet organizative të institucioneve shtetërore).

**Grupi i synuar** i projektit është popullata vulnerabël /e ndjeshme, në komunat e përzgjedhura në pesë vendet e Ballkanit Perëndimor. Grupet e marginalizuara dhe të diskriminuara

konsistojnë kryesisht në anëtarë të pakicave etnike, personat me aftësi të kufizuar, nënat vetushqyese, refugjatë dhe persona të zhvendosur brenda vendit, të moshuarit, homoseksualët, dhe banorët e varfër të zonave rurale.

Në nivelin lokal, projekti është kryesisht aktiv në tri fusha të veprimtarisë (1) "shërbime sociale", (2) "ngritja e vetëdijes", dhe (3) "financimin e shërbimeve sociale lokale ". Një fushë e katërt e aktivitetit (4)"ndarja e përvojave " kontribuon dhe ndërlidh punën e bërë në nivel lokal nëpërmjet masave rajonale dhe ka për qëllim veçanërisht në përmirësimin e kushteve për ndertimin e përvojave në rajon.

### **Fusha e veprimtarisë 1: shërbimet sociale**

- Qëllimi i fushës së parë të veprimtarisë është përmirësimi i kapaciteteve të aktorëve lokalë (qendrave sociale, administratat lokale/ zyrtareve për të drejta të njeriut/barazi gjinore/, OJQ-ve, që ofrojnë shërbime sociale) në terren, në arritjen e grupeve në nevojë.

### **Fusha e veprimtarisë 2: rritja e ndërgjegjësimit**

- Qëllimi i fushës së dytë të aktivitetit është që palët e interesuara në nivelin lokal (qendrat për punë sociale, administratat komunale/ zyrtareve për të drejta të njeriut/barazi gjinore/, OJQ) kanë rritur angazhimin e tyre për ngritjen e vetëdijes së grupeve të rrezikuara për të drejtat e tyre sociale, përfshirë edhe të drejtën për mos diskriminim, së bashku me të drejtat e njeriut dhe institucionet kombëtare kundër diskriminimit.

### **Fusha e veprimtarisë 3: financimi i shërbimeve sociale lokale**

- Fusha e tretë e aktivitetit do të fokusohet në zhvillimin e zgjidhjeve për financimin afatgjatë të shërbimeve sociale lokale për grupet në nevojë. Aktorët lokalë shtetërorë dhe jo-shtetërorë do të jenë të aktivizuara për të zhvilluar dhe zbatuar konceptet e qëndrueshëm të financimit për ofrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë.

### **Fusha e veprimtarisë 4: ndarja e përvojave**

- Fokusi i fushës katërt të veprimtarisë është i vendosur në shkëmbim rajonal të zgjidhjeve dhe ndarjen e përvojave të mira nga praktika, me qëllim të zhvillimit. Qëllimi është që të ketë aktorë në nivel lokal dhe kombëtar dhe të krijojnë kushtet që mundësojnë shpërndarjen zgjidhjeve të suksesshme për përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël, si brenda vendeve të tyre dhe përtej kufijve kombëtarë në Ballkanin Perëndimorë.

## 2. Termat e referencës për përzgjedhjen e OJQ-ve për implementimin e aktiviteteve të parapara sipas planit të veprimit të GP-Projekti 'Të drejtat sociale për grupet vulnerabël /të marginalizuara-SoRi'

Në kuadër të partneritetit në Projekti Rajonal të GIZ-së zyra në Kosovë "Të drejtat sociale për grupet vulnerabël /të marginalizuara-SoRi' dhe Komunës së Prishtinës, respektivisht me Grupin Punues në nivel komunal, i përbërë nga 6 (gjashtë) anëtar, dhe në kuadër të zbatimit të planit të punës<sup>1</sup> së aktiviteteve, janë identifikuar këto dy grupet e ndjeshme për intervenim:

**Grupi i pare: Identifikimi i fëmijëve në situatë rruge dhe puna e fëmijëve**  
**Grupi i dytë: Sigurimi i qasjes për personat me aftësi të kufizuar**

Në bazë të kësaj, ky grup publikon këto kërkesa të cilat duhet të pasqyrohen në projekt propozimet OJQ-ve të cilat do të konkurrojnë për fonde. OJQ-t mund të aplikojnë për njëjërën apo dy grupet e synuara (në një projekt apo dy projekte të ndara por me aktivitete të specifikuar veç e veç për secilin grup të përzgjedhur).

- Përpiloj projekt propozimin, i cilit duhet të jetë i përpiluar sipas standardeve të kërkuara<sup>2</sup> dhe të përmbaj: Përshkrimi i organizatës dhe referencat e listuara, **qëllimin, objektivat, aktivitetet, planin e punës me afate kohore si dhe buxhetin e ndarë në linja buxhetore, sipas aktiviteteve** (max 10 faqe);
- Qëllimi, objektivat dhe aktivitetet duhet të jenë të dizajnuara dhe të përpiluara në mënyrë që të pasqyrojnë nevojat dhe kërkesat e grupeve të identifikuar sipas planit të veprimit të përpiluar nga grupit punues;
- Projektet duhet të fokusohen në vetëdijesimin si të grupit të targetuar po ashtu edhe tek institucioneve përkatëse, njëherit përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për grupet e sipërpërmendura, duke pasur parasysh të kornizën e të drejtave të njeriut, me theks në të drejtat sociale dhe përmbushjen e tyre;
- Fokusi duhet të jetë në: njohjen me të drejtat sociale, mënyra për të i përmbushur ato, institucionet përgjegjëse në nivel komunal (edhe OJQ-të), procedurat e aplikimit për shërbime të ndryshme;
- Fokusi po ashtu duhet të jetë edhe në vetëdijesimin për zhvillimin e punës së vazhdueshme dhe analitike në teren, për të gjitha institucionet dhe OJQ-të që ofrojnë shërbime të ndryshme, njoftimi i grupeve në nevojë, posaçërisht të grupeve të sipërpërmendura;
- OJQ-të po ashtu duhet të konsiderojnë aktivitete për zhvillimin e kapaciteteve të komunitetit për të kërkuar të drejtat e veta dhe realizmin e tyre duke kërkuar shërbimet adekuate
- OJQ-të duhet të i dorëzojnë dokumentet e sipërpërmendura, të kërkuara, në adresën elektronike [premttime.preniqi@rks-gov.net](mailto:premttime.preniqi@rks-gov.net) dhe kopjen fizike në Zyrën pritëse në Komunën e Prishtinës (objekti i vjetër i Komunës së Prishtinës) deri më 10/05/2016, në ora 16:00,

<sup>1</sup> Shih bashkangjitur si aneks nr. 1 dokumentin e 'Planin e veprimit' për grupet e marginalizuara në Prishtinë

<sup>2</sup> Përdor formatin e narrativit bashkangjitur si aneks nr 2.

- Do të kontaktohen vetëm OJQ-të të cilat janë përzgjedhur

### **3. Kriteret për përzgjedhjen e OJQ-ve, si partner bashkëpunues-GIZ/SORI**

- OJQ, të jetë e regjistruar apo/edhe e licencuar për të vepruar në Komunën Përkatëse;
- OJQ të ketë vizionin dhe misionin e qartë si dhe strukturat menaxhuese të përcaktuara që mundësojnë zbatimin e mirëfilltë të projekteve të ndryshme ;
- OJQ të ketë dëshmi të projekteve të implementuara më herët apo për ato që është në zbatim e sipër- duke dëshmuar: donatorët që kanë financuar projektin, synimin dhe objektivat dhe bashkëpunim me strukturat komunale dhe cilësinë e këtyre bashkëpunimeve;
- OJQ të dëshmoj se ka: ekspertizën, eksperiencën dhe qasjen tek grupet vulnerabël/të ndryshme dhe se ka strukturat e veta të cilat mundësojnë komunikimin dhe bashkëpunimin e përditshëm si me këto grupe ashtu edhe me strukturat komunale, në komunat përkatëse;
- OJQ të ketë ekspertizë në zbatimin e projekteve për ngritje të vetëdijes të grupeve të ndryshme vulnerabël/të ndryshme;
- OJQ të dorëzoj projekt propozimin, planin e veprimit dhe buxhetin tek personi relevant në Komunë, sipas dakordimit të përgjithshëm të qëllimit të projektit;
- OJQ të jetë e gatshme për të bashkëpunuar dhe raportuar për ecurinë e projektit dhe shpenzimet, përveç tek financuesi-GIZ/SORI, po ashtu edhe tek grupi punues në nivel komunal;
- OJQ të caktoj një person përgjegjës të projektit i cili do të marrë pjesë rregullisht në takimet e grupit punues në nivel komunal, me qëllim të raportimit, koordinimit dhe bashkëpunimit;
- OJQ të jetë e hapur për monitorimin, vëzhgimin dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të grupit punues në aktivitetet e parapara.

#### 4. BUXHETI

- Shuma totale e buxhetit të ndare për financimin e projekteve të OJQ-ve në pesë komuna është parashikua të arrijnë në total 45.000 Euro.
- Shuma e lartë cekur do të ndahet në pesë komunat, pjese të projektit dhe do të jetë nga 5.000 deri 15.000 Euro për një komunë (në varësi nga numri i aplikacioneve dhe përmbajtja e tyre).
- Në secilën komunë parashihet të financohen 1 deri 2 projekte.
- Projektet që aplikojnë me shuma mbi 15.000 Euro nuk do të merren parasysh.
- Buxheti i aplikuarve duhet të jete i detalizuar në vija buxhetore dhe përshkrim narrativ të aktiviteteve që përkojnë me linjat buxhetore.
- Buxheti i aplikuarve nuk duhet të kaloje 30% të totalit për pjesën administrative (paga/mëditje, transport, komunikim etj). Mbi 70% duhet të rezultojnë si shpenzime direkt për aktivitetet e parapara<sup>3</sup>.
- Buxheti duhet të paraqitet i veçantë në programin Excel.
- Projekti parashihet të implementohet në disa faza. Faza e parë 3-6 muaj, pra projektet duhet të kenë kohëzgjatje prej 3-6 muaj duke filluar nga muaji Maj 2016.
- Projekti nuk parasheh të mbuloje komponente të ndonjë projektit tjetër ekzistues.
- Projekti, në rast se vecanta, mund të konsideroj kofinancim me fondet kominale.
- Donatori mban të drejtën të negocioje vijat buxhetore dhe aktivitetet specifike me OJQ-t që përzgjidhen.
- Donatori mban të drejtën të tërhiqet nga financimi në rast se projektet nuk përmbushin kriteret minimale; në rast se aplikuesit nuk demonstrojnë nivel profesional për realizimin e projekteve të propozuara; në rast të nevojës për të rialokuar fondet brenda projektit.
- Donatori mban të drejtën të tërhiqet nga një apo më shumë komuna nga financimi dhe bashkëpunimi në kuadër të projektit SoRi.

---

<sup>3</sup> Përdor formatin e buxhetit në annex nr 3.